



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.10. 2011

V E N D I M

Nr.1711, datë 31.10. 2011

Për

“Përcaktimin e sipërmarrjes Eagle Mobile sh.a me Fuqi te Ndjeshme në Treg dhe vendosjen e masave rregulluese në: Tregun me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetin publik të telefonise të lëvizshme Eagle Mobile”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
4. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare te Keshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e dates 31.10.2011, sipas procedurës së percaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Per Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores se Brendshme të AKEP-it, me objekt:

Vlerësimin e Eagle Mobile Sh.a sipërmarrës me FNT dhe vendosjen e masave rregulluese në tregun përkatës të terminimit të SMS-ve mbi., mbi bazën e dokumentit: “Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme , Dokumenti Perfundimtar”, si dhe vendosjen e masave rregulluese.

mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Rregullimit Ekonomik, të përbërë nga:

-Relacioni shpjegues;

-Dokumenti “Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme , Dokumenti Perfundimtar”

-Projektvendimi i KD i formatuar dhe arsyetuar sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 106 e në vijim të ligjit nr. 8485.

BAZA LIGJORE:

1. Gërma ç) e neni 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Shkronja e) e pikes 1 dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores se Brendeshme te AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Keshillit Drejtues të ERT-se, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. “Rregullore për analizen e tregut”, miratuar me vendimin nr. 747, date 17.07.2009, të Keshillit Drejtues të AKEP (**Rregullorja**).

KESHILLI DREJTUES

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. Dokumenti “*Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme , Dokumenti Perfundimtar*”, reflekton punën e Drejtorisë së Rregullimit Ekonomik si dhe komentet dhe vërejtjet e bëra gjatë mbledhjes.
2. Dokumenti “*Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme , Dokumenti Perfundimtar*”
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në baze të të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. është përgatitur pas kryerjes së keshillimit publik dhe përmban komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimin e AKEP për komentet në përputhje me nenin 35 të Ligjit 9918;
 - c. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizen e tregut;
 - d. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizën e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës dhe analizën e testit të tre kriterëve, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;

- e. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Europian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Europian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut në Shqipëri;
- f. vendosja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë bazën e vlerësimit të pozitës në tregjet përkatëse të sipërmarrësit Eagle Mobile Sh.a., sipas dokumentit “*Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme, Dokumenti Perfundimtar*”, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918 dhe shkronjes e) të pikës 1 dhe pikës 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, si dhe në zbatim të kompetencës ligjore të përcaktuar në shkronjën ç) të nenit 8 të ligjit nr. 9918, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S :

1. Te miratojë Dokumentin “*Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme, Dokumenti Perfundimtar*” dhe mbi bazën e tij të përcaktojë sipërmarrësin Eagle Mobile Sh.a., sipërmarrës me FNT në tregun përkatës të mëposhtëm:

- Tregun me shumicë të terminimit të mesazheve SMS në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Eagle Mobile

Zona gjeografike e tregut përkatës është kombëtare apo territori i Republikës së Shqipërisë.

2. Sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a. i përcaktuar sipërmarrës me FNT, është i detyruar të zbatojë të gjitha detyrimet përkatëse në këtë treg, si më poshtë, por pa u kufizuar:

1. Detyrimi i mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918
2. Detyrimi i transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918.
3. Detyrimi për ndarjen e llogarive, sipas nenit 41 të ligjit nr. 9918.
4. Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i përbashkët i faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918
5. Detyrimi për kontroll të tarifave dhe orientim në kosto, sipas nenit 45 të ligjit nr. 9918.

3. Detyrimet e mësipërme në pikën 2, përfshijnë midis të tjerave:

a. Detyrimi i Mosdiskriminimit:

- Sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a., për terminimin e SMS-ve në rrjetin e vet të zbatojë kushte të njëjta, në rrethana të njëjta ndaj sipërmarrësve të tjerë, që ofrojnë shërbime ekuivalente, si dhe t'u ofrojë sipërmarrësve të tjerë shërbime dhe informacion në kushte të njëjta dhe me cilësi të njëjtë, sikunder ai i ofron për shërbimet e veta, për filialet ose partnerët e tij;

3.2 Detyrimi i transparencës:

- Sipërmarrësi Eagle Mobile sh.a., duhet:
 - a) të publikojë tarifatat, përfshirë zbritjet e mundshme për terminimin e SMS-ve në rrjetin e vet ;
 - b) të depozitojë në AKEP marrveshjet e interkoneksionit për SMS-të.

3.3 Detyrimi për akses dhe interkoneksion dhe përdorimi i perbashket i faciliteteve të rrjetit për terminimin e SMS-ve:

- t'u ofrojë palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij
- të ofrojë shërbime të veçanta në nivel shumice, për t'u rishitur nga palet e treta;
- të mos anulohet aksesin në facilitetet, kur e ka dhënë atë;
- të negociojë me dëshirën e mirë dhe me mirëbesim me subjektet, që kërkojnë akses;
- të ofrojë akses të hapur në nderfaqet teknike, protokollet ose teknologjitë e tjera të rendesishme, të domosdoshme për nderveprimin e shërbimeve ose për shërbimet e rrjetit virtual;
- të ofrojë bashkevendosje ose forma të tjera të përdorimit të perbashket, përfshirë ndertesat, tubacionet kabllorë ose shtyllat, kullat;
- të krijojë kushtet e nevojshme për të siguruar nderveprimin e shërbimeve pike fundore – pike fundore, duke përfshirë facilitetet për shërbimet e rrjetit inteligjent;
- të ofrojë akses në sistemet mbështetëse funksionale ose sistemet e ngjashme informatike (softëare), të nevojshme, për të siguruar konkurrencë të ndershme në ofrimin e shërbimeve;

3.4 Detyrimi për ndarjen e llogarive dhe detyrimi për kontroll të tarifave dhe sistemin e mbajtjes së llogarive:

1. Tarifa terminimit të SMS-ve në rrjetin Eagle Mobile është objekt kontrolli dhe rregullimi nga AKEP.
2. Niveli i tarifës së terminimit të SMS-ve duhet të jetë i orientuar në kostot BULRAIC, duke bërë reduktim gradual të kësaj tarife. Barazimi i tarifës me koston BULRAIC si dhe detyrimi i ndarjes së llogarive për shërbimin e terminimit të SMS-ve do të kryhet sipas përcaktimeve të mëvonshme të AKEP.

3. Në përputhje me nenin 57, pika 1/a dhe neni 59 pika 2, niveli maksimal i tarifës së terminimit të SMS-ve në rrjetin Eagle Mobile të jetë sipas vlerave dhe afateve në tabelën e mëposhtëme:

	Aktuale- 31.12.2011	1.01.2012- 31.08.2012	1.09.2012- 31.08.2013	1.09.2013-
Tarifa e terminimit të SMS-ve	3.00	2.40	2.00	1.44

Tarifat në Lek/SMS pa TVSH

- 4 Afati i vlefshmërisë së statusit me FNT në tregun përkates për sipërmarrësin Eagle Mobile sh.a., është deri në nxjerrjen e një vendimi tjetër nga AKEP mbi bazën e analizës së tregut të kryer sipas nenit 34 të Ligjit 9918.
- 5 Dokumenti “*Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme, Dokumenti Perfundimtar*”, i bashkëngjitet këtij vendimi si Aneks 1 dhe është pjesë e tij.
- 6 Kundra këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Këshillin Drejtues të AKEP, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi ne datën e miratimit te tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Alketa MUKAVELATI**
- 3. Benon PALOKA**
- 4. Zamira NURCE**

ANEKS 1

“Analize e Tregut, Tregjet me shumicë të terminimit të SMS-ve në rrjetet publike telefonike të lëvizshme , Dokumenti Perfundimtar”